



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja **a**, dhe të nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 19.05.2017, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Fatime (Hasan) Hajrizi, Ali Aliu, Ilir (Fetah) Fetahaj dhe Fetah (Rexhë) Fetahaj.
- II. Prona e paluajtshme e Komunës që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesa e parcelës kadastrale nr. 1949-1, Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë P-71914075-01949-1, e evidentuar si "pasuri shoqërore - rrugë", kurse pronat e paluajtshme që merret nga ky këmbim janë: pjesa e parcelës kadastrale nr. 1828-9, Zona kadastrale Prishtinë, e evidentuar në Certifikatën e pronësisë P-71914059-01828-9, në pronësi të Fatime (Hasan) Hajrizit; pjesa e parcelës kadastrale nr. 1828-10, Zona kadastrale Prishtinë, e evidentuar në Certifikatën e pronësisë P-71914059-01828-10, në pronësi të Ali Aliut; pjesa e parcelës kadastrale nr. 1828-11, Zona kadastrale Prishtinë, e evidentuar në Certifikatën e pronësisë P-71914059-01828-11, në pronësi të Ilir (Fetah) Fetahajt; pjesa e parcelës kadastrale nr. 1828-12, Zona kadastrale Prishtinë, e evidentuar në Certifikatën e pronësisë P-71914059-01828-12, në pronësi të Fetah Fetahajt.
- III. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e planit rregullues urban. Kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të Komunës dhe se kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.

- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelave kadastrale që do të këmbehen.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/03-0118217/17, më 22.05.2017



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dpl.